25732

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E RRETHIT TIRANË**
**Nr. 25732**

# VENDIM PËR REGJISTRIM PERSONI JURIDIK

Sot, më datë 03 Maj 2001, unë Graciela Cefo gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studiova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga z.Xhafer Fiora në cilësinë e ortakut te vetem dhe administratorit te shoqerise "ALXHEF" Sh.p.k për regjistrimin e kësaj shoqërie si person juridik,

## KONSTATOVA SE:

Shoqëria "ALXHEF" Sh.p.k është person juridik i së drejtës shqiptare dhe eshte themeluar nga ortaku i vetem z. Xhafer Fiora, lindur me 15/10/1966, i biri i Sinanit, lindur dhe banues ne Fushe-Preze.
Selia e shoqërisë është në Fushe-Preze, Tirane, Shqipëri.
Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- Perpunimi I materilait te drurit;
- Importi dhe Eksporti I lendes se drurit;
- Prodhim mobiljesh;
- Tregteim me shumice dhe pakice
- Importimi I materilait te drurit;
- Importimi I materialeve te ndryshme.

Emertimi i shoqerise do te jete "ALXHEF"Sh.p.k
Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do te jete per nje afat prej 20 vjetesh.
Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njeqindmije).
Shoqeria do te perbehet nga nje ortak qe eshte z. Xhafer Fiora i cili zoteron 100% te kapitalit themeltar.
Administrator është z. Xhafer Fiora.

## PËR KËTO ARSYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e çmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 APër Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare".

## VENDOSA:

- Pranimin e Kërkesës;
- Regjistrimin e Shoqërisë me pergjegjesi te kufizuar "ALXHEF"Sh.p.k si person juridik.

Selia e shoqërisë është në Fushe-Preze, Tirane, Shqipëri.
Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- Perpunimi i materilait te drurit;
- Importi dhe Eksporti i lendes se drurit;
- Prodhim mobiljesh;
- Tregteim me shumice dhe pakice
- Importimi i materilait te drurit;
- Importimi i materialeve te ndryshme.

Emertimi i shoqerise do te jete "ALXHEF"Sh.p.k
Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do te jete per nje afat prej 20 vjetesh.
Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njeqindmije).
Shoqeria do te perbehet nga nje ortak qe eshte z. Xhafer Fiora i cili zoteron 100% te kapitalit themeltar.
Administrator është z. Xhafer Fiora.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit.

**GJYQTARE**

Armila Copo

**AKTI I THEMELIMIT**
**I**
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**"ALXHEF" Sh.p.k.**

**Neni 1**
**Ortaket themelues**

Shoqeria "ALXHEF"Sh.p.k, themelohet nga Ortaku i Vetem:

1. **Z. Xhafer Fiora,** shtetas shqiptar, lindur ne Fushe-Preze, Tirane me 15/101966, banues ne Fushe-Preze, Tirane, mbajtes i pasaportes me N.1010069;

**Neni 2**
**Emertimi**

2.1 Shoqeria emertohet "ALXHEF" sh.p.k.

**Neni 3**
**Forma dhe baza ligjore**

3.1 Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k), ne baze te ligjit "Per shoqerite tregtare".

3.2 Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter me vendimin e Ortakut te Vetem.

3.3 Shoqeria "ALXHEF" sh.p.k., do te kryeje veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, ligjin nr. 7638 date 19 Nentor 1992 "Per shoqerite tregtare" dhe dispozitat e tjera te legjislacionit shqiptar.

**Neni 4**
**Kohezgjatja**

4.1 Veprimtaria e Shoqerise do te jete filloje pas regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit te Tiranes. Veprimtaria e shoqerise do te zgjase per nje periudhe 20 vjecare.

**Neni 5**
**Selia**

5.1 Selia e shoqerise eshte ne Fushe-Preze, Tirane, Shqiperi.

5.2 Shoqeria ka te drejte te krijoje dege, filiale ose / dhe zyra perfaqesimi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, dhe jashte vendit.

**Neni 6**

## Objekti

6.1 Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

-Perpunimi i materialit te drurit;
-Importi dhe eksporti i lendes drusore;
-Prodhim mobiljesh;
-Tregtim me shmice dhe pakice;
-Importimi i materialeve te ndertimit;
-Importimi i materialeve te ndryshme.

6.2 Objekti i shoqeise mund te zgjerohet ose ndryshoje me vendim te ortakut te vetem.

## Neni 7
## Kapitali

7.1 Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 (njeqindmije) leke, teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaku I vetem perpara regjistrimit te shoqerise ne Gjykate.

7.2 Kapitali eshte ndare ne 100 (njeqind) pjese, secila me vlere nominale 1000 leke (njemije).

7.3 Pjeset e kapitalit zoterohen teresisht nga ortaku i vetem

## Neni 8
## Vendimet e Ortakut te Vetem. Administrimi

8.1 Vendimet kryesore merren nga Ortaku i Vetem. Ortaku i Vetem drejton veprimtarine e shoqerise nepermjet marrjes se vendimeve sic percaktohet ne Statut.

8.2 Shoqeria do te administrohet nga Ortaku i Vetem, z. Xhafer Fiora.

## Neni 9
## Eksperti kontabel i autorizuar

91. Eksperti (ekspertet) kontabel i autorizuar do te caktohen me vendim te Ortakut te Vetem ne rast se do te permbushen dy prej tre kushteve te percaktuara nga ligji.

9.2 Eksperti (ekspertet) kontabel i autorizuar do te qendroje ne detyre per nje periudhe 6 vjecare.

## Neni 10
## Viti financiar

10.1 Viti financiar i shoqerise perputhet me vitin kalendarik, duke filluar ne 1 janari dhe mbaron me 31 dhjetor. Si perjashtim, viti i pare i veprimtarise se shoqerise dhe do te filloje nga dita e regjistrimit te shoqerise prane organeve tatimore dhe perfundon me 31 Dhjetor 2001.

## Neni 11
## Bilanci. Mbajtja e kontabilitetit

11.1 Bilanci vjetor i Shoqerise shqyrtohet nga Ortaku i Vetem dhe duhet te hartohet per t'iu paraqitur organeve tatimore, deri ne fund te muajit mars te vitit pasardhes.

11.2 Kontabiliteti mbahet ne gjuhen dhe ne monedhen Shqiptare. Shoqeria mund te kete edhe llogari te vecanta ne valute te cilat do te konvertohen cdo muaj ne monedhe shqiptare.

## Neni 12
## Te ardhurat. Dividendi

12.1 Shoqeria do te krijoje fonde rezerve per realizimin e objektit te saj.

12.2 Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo ushtrimori, pas pagimit te tatimeve, do ti shperndahen si dividend Ortakut te Vetem.

## Neni 13
## Likuidimi

13.1 Shoqeria do te hyje ne procesin e likujdimit, nese:

- gjendja ekonomike ne Shqiperi nuk do te lejoje vazhdimin e veprimtarise se shoqerise;
- Ortaku i Vetem vendos te prishe shoqerine.

13.2 Ne menyre qe te ndermarre procedurat e likujdimit, Ortaku i Vetem emeron nje likuidator ose nje grup likuidatoresh,

## Neni 14
## Zgjidhja e mosmarreveshjeve

14.1 Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten, palet i drejtohen per zgjidhje gjykates se Tiranes.

## Neni 15
## Klauzola mbyllese

15.1 Ky Akt themelimi hartohet ne 5 ekzemplare, secili me vlere te njejte ligjore.

## ORTAKU THEMELUES

**XHAFER FIORA**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
NR. 67 REP.
NR. 81 KOL.

## VERTETIM

Sot, me date 26/01/2001, para meje, ________, noter i Dhomes se Noterise Tirane, u paraqiten personalisht:
z. Xhafer Fiora, shtetas shqiptar, i biri i Sinanit, i datelindjes 15/10/1966, lindur dhe banues ne Fushe Preze, Tirane, mbajtes i pasaportes me Nr. 1010069, madhore, me zotesi per te vepruar i cili me deklaroi se kete Akt Themelimi e kishte nenshkruar me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe une noteri vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

**NOTERI**

PULLE TAKSE
REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTER
TIRANE

**STATUTI**
**I**
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**"ALXHEF" Sh.p.k.**

## I. THEMELIMI

### Neni 1
### Ortaket themelues

1.1 Shoqeria "ALXHEF" Sh.p.k themelohet nga ortaku i vetem:

1. **Xhafer Fiora,** shtetas shqiptar, lindur ne Preze, Tirane me 15/10/1966, banues ne Fushe-Preze Tirane, mbajtes i pasaportes me Nr. 1010069

## II. EMERTIMI. SELIA. FORMA LIGJORE

### Neni 2
### Emertimi

2.1 Shoqeria emertohet "ALXHEF" sh.p.k.

### Neni 3
### Forma ligjore

3.1 Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k), ne baze te ligjit "Per shoqerite tregtare".

3.2 Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter me vendimin e duhur te Ortakeve.

### Neni 4
### Baza ligjore

4.1 Shoqeria "ALXHEF" sh.p.k., do te kryeje veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, me kete Statut, ligjin nr. 7638 date 19 Nentor 1992 "Per shoqerite tregtare" dhe dispozitat e tjera te legjislacionit shqiptar.

### Neni 5
### Kohezgjatja

5.1 Veprimtaria e Shoqerise do te jete filloje pas regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit te Tiranes.

5.2 Veprimtaria e shoqerise do te zgjase per nje periudhe 20 vjecare.

**Neni 6**
**Selia**

6.1 Selia e shoqerise eshte ne Fushe-Preze Tirane, Shqiperi.

6.2 Shoqeria ka te drejte te krijoje dege, filiale ose / dhe zyra perfaqesimi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, dhe jashte vendit.

6.3 Shoqeria parashikon edhe mundesine e pjesemarrjes ne shoqeri te tjera ekzistuese ose ne shoqeri qe ne te ardhmen do te zhvillojne veprimtari ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte tij.

**Neni 7**
**Emblema.Vula**

7.1 Shoqeria do te kete vulen e saj qe do te perdoret nga administratori

7.2 Forma e vules dhe permasat e saj do te percaktohen nga Ortaku i Vetem ne perputhje me kerkesat perkatese ligjore ne Shqiperi.

**Neni 8**
**Objekti**

8.1 Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

-Perpunimi i materialit te drurit;
-Importi dhe eksporti i lendes drusore;
-Prodhim mobiljesh;
-Tregtim me shmice dhe pakice;
-Importimi i materialeve te ndertimit;
- Importimi i materialeve te ndryshme

8.2 Objekti i shoqeise mund te zgjerohet ose ndryshoje me vendim te ortakut te vetem.

**Neni 9**
**Kapitali**

9.1 Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 (njeqindmije) leke, teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetem perpara regjistrimit te shoqerise ne Gjykate.

9.2 Kapitali eshte ndare ne 100 (njeqind) pjese, secila me vlere nominale 1000 leke (njemije).

9.3 Pjeset e kapitalit zoterohen teresisht nga ortaku i vetem

**Neni 10**
**Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar**

10.1 Pjeset e kapitalit themeltar mund te transferohen vetem me akt noterial.

10.2 Pjeset e kapitalit mund t'u transferohen edhe te treteve,

10.3 Pjeset e kapitalit transferohen me vendimin te ortakut te vetem.

10.4 Pjeset e kapitalit transferohen automatikisht ne rruge trashegimie.

**Neni 11**
**Zmadhimi i kapitalit themeltar**

11.1 Ortaku i vetem mund te vendose lirisht ne cdo kohe ritjen e kapitalit.

**Neni 12**
**Zvogelimi i kapitalit themeltar**

12.1 Zvogelimi i kapitalit do te behet sipas procedurave te parashikuara ne ligjin "Per shoqerite tregtare".

12.2 Projekti i zvogelimit i paraqitet ekspertit kontabel te autorizuar ose administratoreve, te pakten 45 dite para Asamblese se thirrur per kete qellim. Eksperti kontabel i autorizuar ose administratori shqyrtone projektin dhe i paraqet Ortakut te Vetem raportin lidhur me shkaqet dhe kushtet e zvogelimit te kapitalit themeltar.

12.3 Raportin e zvogelimit miratohet ne menyre te shprehur nga Ortaku i Vetem.

## ORGANET E SHOQERISE

**Neni 13**
**Vendimet e Ortakut te Vetem**

13.1 Vendimet kryesore merren nga Ortaku i Vetem.

13.2 Ortaku i Vetem drejton veprimtarine e shoqerise nepermjet marrjes se vendimeve. Vendimet e Ortakut perfshijne kryesisht:

- ndryshimin e selise;
- ndryshimin e emertimit te shoqerise;
- rritjen ose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise;
- shitjen ose transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar paleve te treta;
- prishjen e shoqerise;

likuidimin e shoqerise;
emerimin ose shkarkimin e administratorit / administratoreve te shoqerise
miratimin e bilancit te shoqerise si dhe ekspertit kontabel.
transformimin e shoqerise ne forma te tjera.

**Neni 14**
**Administrimi**

14.1 Administrimi i shoqerise kryhet nga nje administrator ose nga nje grup administratoresh qe caktohen nga Ortaku i Vetem.

14.2 Administratoret nuk jane detyrimisht ortake, por mund te jene edhe jo ortake.

14.3 Administratoret kane te drejte te perfaqesojne shoqerine dhe drejtojne punen e perditshme te shoqerise ne perputhje me udhezimet e Ortakut te Vetem.

14.4 Administratoret jane solidarisht pergjigjes per veprimtarite e meposhtme:

- drejtimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise;
- perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me te tretet personalisht ose duke caktuar zevendesues;
- pergatitjen e mbledhjeve te Asambleve te Ortakeve dhe plotesimin e procedurave te thirrjes se tyre;
- hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit vete; emerimin e eksperteve kontabel, ne rast nevoje;
- pergatitjen e dokumenteve ne emer te shoqerise sipas kompetencave qe kane;
- lidhin kontrata pune dhe i zgjidhin ato sipas rastit;
- zhvillojne veprimtari te tjera te cdo lloj natyre per te miren e shoqerise dhe realizimin
e objektit te shoqerise.

14.5 Shoqeria do te administrohet nga Ortaku i Vetem z. Xhafer Fiora

**Neni 15**
**Eksperti kontabel i autorizuar**

15.1 Eksperti (ekspertet) kontabel i autorizuar do te caktohen me vendim te Ortakut te Vetem me shumice te thjeshte votash ne rast se do te permbushen dy prej tre kushteve te percaktuara nga ligji.

15.2 Eksperti (ekspertet) kontabel i autorizuar do te qendroje ne detyre per nje periudhe 6 vjecare.

## Neni 16
## Viti financiar

16.1 Viti financiar i shoqerise perputhet me vitin kalendarik, duke filluar ne 1 janari dhe mbaron me 31 dhjetor.

16.2 Si perjashtim, viti i pare i veprimtarise se shoqerise dhe do te filloje nga dita e regjistrimit te shoqerise prane organeve tatimore dhe perfundon me 31 Dhjetor 2001.

## Neni 17
## Bilanci. Mbajtja e kontabilitetit

17.1 Bilanci vjetor i Shoqerise shqyrtohet nga Ortaku i Vetem dhe duhet te hartohet per t'iu paraqitur organeve tatimore, deri ne fund te muajit mars te vitit pasardhes.

17.2 Kontabiliteti mbahet ne gjuhen dhe ne monedhen Shqiptare. Shoqeria mund te kete edhe llogari te vecanta ne valute te cilat do te konvertohen cdo muaj ne monedhe shqiptare.

17.3 Shoqeria mund te marre financime nga institucione financiare qe operojne ne Shqiperi ose jashte saj. Per kete qellim shoqeria mund te vendose si garanci pengun mbi pjeset e kapitalit ose sende te paluajtshme, me autorizim te Ortakut te Vetem.

## Neni 18
## Te ardhurat. Dividendi

18.1 Shoqeria do te krijoje fonde rezerve per realizimin e objektit te saj.

18.2 Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo ushtrimori, pas pagimit te tatimeve, do te shperndahet si dividend Ortakut te Vetem.

## Neni 19
## Likuidimi

19.1 Shoqeria do te hyje ne procesin e likujdimit, nese:

- gjendja ekonomike ne Shqiperi nuk do te lejoje vazhdimin e veprimtarise se shoqerise;
- Ortaku i Vetem vendos te prishe shoqerine.

19.2 Ne menyre qe te ndermarre procedurat e likujdimit, Ortaku i Vetem emeron nje likuidator ose nje grup likuidatoresh,

19.3 Likuidatori/likuidatoret do te raportojne mbi gjendjen e zerave te aktivit dhe te pasivit te shoqerise rreth operacioneve te metejshme te likuidimit dhe kohen qe nevojitet per perfundimin e tij. Ne fund te ketij procesi, Ortaku i Vetem shqyrton bilancin perfundimtar dhe mbylljen e procedures se likuidimit.

**Neni 20**
**Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

20.1 Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten, palet i drejtohen per zgjidhje gjykates se Tiranes.

**Neni 21**
**Klauzola mbyllese**

21.1 Ky statut hartohet ne 5 ekzemplare, ne gjuhen Shqipe.

**ORTAKU THEMELUES**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
NR. 679 REP.
NR. 81 KOL.

**VERTETIM**

Sot, me date 26/04/2001, para meje, ______, noter i Dhomes se Noterise Tirane, u paraqiten personalisht:
z. Xhafer Fiora, shtetas shqiptar, i biri i Sinanit, i datelindjes 15/10/1966, lindur dhe banues ne Fushe Preze, Tirane, mbajtes i pasaportes me Nr.1010069, madhore, me zotesi per te vepruar i cili me deklaroi se kete Statut e kishte nenshkruar me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe une noteri vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

NOTERI

(1)

3y A Copo
87 dt 2001
27 APR. 2001

**KERKESE**
**PER REGJISTRIM PERSONI JURIDIK**

***Kerkuesi:*** Shoqeria "ALXHEF" SHPK perfaqesuar nga administratori Xhafer Fiora.

***Objekti:*** Regjistrimi i personit juridik "ALXHEF" SHPK 25732

***Baza ligjore:*** Ligji Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare≅, dhe Ligji Nr. 7667, date 28.01.1993, "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

**Gjykates se Rrethit Tirane**

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

Shoqeria "ALXHEF" SHPK themelohet nga ortaku i vetem z. Xhafer Fiora, lindur me 15/10/1966 i biri i Sinanit lindur dhe banues ne Fushe-Preze, Tirane, mbajtes i pasaportes 1010069.

Emri i shoqerisë është "ALXHEF" SHPK.
Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë per nje afat prej 20 vjetesh.
Selia e shoqerisë është në adresën: Fushe-Preze, Tiranë, Shqipëri.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është :

-Perpunimi i materialit te drurit;
-Importi dhe ekpsorti i lendes se drurit;
-Prodhim mobiljesh;
-Tregtim ne shumice dhe pakice;
-Importimi i materialeve të drurit;
-Importimi i materialeve te ndryshme.

03.05.2001

Kapitali themeltar i shoqerisë është 100.000 (një qind mijë) lekë, i nënshkruar dhe i shlyer plotësisht nga ortaku i vetem.

Kapitali është ndarë në 100 (një qind) pjesë, me vlerë nominale 1000 (një mijë) lekë secila. Pjesët e kapitalit zotërohen 100% nga ortaku i vetem.

Bazuar ne sa me siper si dhe ne Ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", dhe Ligjin Nr. 7667, date 28.01.1993, "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare", parashtroj kete kerkese per regjistrimin si person juridik ne Regjistrin Tregtar te shoqerise.

**KERKUESI**
**Per shoqerine "ALXHEF"Sh.p.k**

**Xhafer Fiora**
(Administrator)

Xhafer Fiora

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE TIRANE

NR 1. REGJ

# V E R T E T I M

Ne Tirane date 26/01/ 2001(dymije e nje),para meje noteres Lindita LLeshi,u paraqit shtetasi Xhafer Fiora,me banim ne Fushe Preze, rrethi Tirane,me pas nr 1010069,madhor e me zotesi te plote per te vepruar,me cilesine e ortakut te vetem dhe administrator i sho-qerise me pergjegjesi te kufizuar" ALXHEF" shpk ne krijim e siper i cili depozitoj ne kete zyre vleren e kapitalit fillestar prej 100.000(njeqind mije)lek deri ne perfundim te regjistrimit te kesaj shoqerie si person juridik ne Gjykaten e rrethit Tirane. Leshoj dokumentin per efekt perdorimi ne Gjykaten e Tiranes.




N O T E R E

Lindita LLeshi

## URDHER – REGJISTRIMI

1 25732

2 (a) Emertimi: "Alxhef. Sh.p.k.

(b) Selia: Fushe Preze Tirane

(c) Objekti: Perpunim materiali druri, impiant i [illegible]

(ç) Kapitali: 100.000 leke.

3.Administrator i shoqerise Xhafer Tirqa.

4. Statuti eshte nenshkruar me dt. 26.04.2001

5.Regjistruar me dt. 03.05.2001.

Mandat Arketimi Vertetim nga noteri Linolita Lleshi

Gjyqtare